



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 403 Prot.

Tiranë, më 11.06 2015

VENDIM Nr. 61 datë 04.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, të datës 04.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Qyteti mesjetar Drisht (Shkodër)"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues të tij Prof. Luan Përzhita dhe doktorant Paulin Pushimaj,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Qyteti mesjetar Drisht (Shkodër)"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues të tij Prof. Luan Përzhita dhe doktorant Paulin Pushimaj, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Kryerja e një ekspedite përnjohëse në zonën e qytetit mesjetar të Drishtit, vazhdimi i punës për plotësimin me planimetri të qytetit, pastrimi dhe dokumentimi i kishës mesjetare të zbuluar nga gërmimet e rastit në brëndësi të qytetit mesjetar.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë brenda vitit 2015.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO